



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04
Prokurori kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 22 prill 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i

Vendimit në lidhje me Rishqyrtimin e Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin dhe për Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Pjetër Shalës

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtjes së të akuzuarit

Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtësit të viktimave

Sajmon Loz

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenin 41(6), (10) dhe (12) të Ligjit Nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 qershor 2020, pas vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake (“Vendimi i Konfirmimit”),² Prokurori i Specializuar dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar.³
2. Më 16 mars 2021, pas vendimit dhe fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,⁴ Pjetër Shala (“z. Shala” ose “i akuzuari”) u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës (“Belgjikë”).⁵

¹ KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-04, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik u nxorën më 6 maj 2021, F00007/CONF/RED dhe F00007/RED.

³ KSC-BC-2020-04, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale. Versioni konfidencial me më pak redaktime dhe versioni publik i redaktuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzuan më 31 mars 2021, F00016/A01, konfidencial, F00016/A02, publik. Versioni konfidencial me edhe më pak redaktime i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 25 maj 2021, F00038/A01. Pas vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për mocionin e Mbrojtjes që kundërshton formën e Aktakuzës së Konfirmuar, u dorëzua një aktakuzë e korrigjuar më 1 nëntor 2021, F00098/A01, konfidenciale, dhe 16 nëntor 2021, F00107/A01, publike.

⁴ KSC-BC-2020-04, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Urdhrit të Transferimit*, 12 qershor 2020, konfidencial (versioni i redaktuar publik u nxor më 6 maj 2021, F00008/RED); F00008/A01, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestim për z. Pjetër Shala*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (versioni i redaktuar publik u nxor më 15 prill 2021, F00008/A01/RED).

⁵ KSC-BC-2020-04, F00013, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 16 mars 2021, publik.

3. Më 15 prill 2021, me përfundimin e procedurave gjyqësore në Belgjikë, z. Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS") në Hagë, Holandë.⁶
4. Më 15 qershor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hodhi poshtë kërkesën për lirim të përkohshëm të parashtruar nga Mbrojtja e z. Shala ("Mbrojtja") ("Vendimi i Parë për Paraburgimin").⁷ Gjykata e Apelit e la në fuqi Vendimin e Parë për Paraburgimin më 20 gusht 2021 ("Vendimi i Parë i Gjykatës së Apelit").⁸
5. Më 10 shtator 2021, 10 nëntor 2021 dhe 28 janar 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e rishikoi paraburgimin e z. Shala dhe urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të tij (përkatësisht "Vendimi i Dytë për Paraburgimin", "Vendimi i Tretë për Paraburgimin" dhe "Vendimi i Katërt për Paraburgimin").⁹
6. Më 11 shkurt 2022, Gjykata e Apelit nxori Vendimin në lidhje Apelin e Mbrojtjes kundër Vendimit të Tretë për Paraburgimin ("Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit").¹⁰ Ndër të tjera, Gjykata e Apelit ia ktheu Vendimin e Tretë për Paraburgimin Gjykatësit të Procedurës Paraprake për shqyrtim të mëtejshëm, me qëllim që të kërkonte parashtrime të tjera nga Administratorja për regjimin e paraburgimit në objektin e paraburgimit të DHS-së dhe të ftonte Mbrojtjen që të kërkonte informacion nëse

⁶ KSC-BC-2020-04, F00019, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit*, 15 prill 2021, konfidencial, para. 2, me Shtojcat 1-2, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u nxor më 26 prill 2021, F00019/RED.

⁷ KSC-BC-2020-04, F00045, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Pjetër Shalës për Lirim të Përkohshëm*, 15 qershor 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u nxor më 23 qershor 2021, F00045/RED.

⁸ KSC-BC-2020-04, IA001/F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit për Lirim të Përkohshëm*, 20 gusht 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, IA001/F00005/RED.

⁹ KSC-BC-2020-04, F00075, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës*, 10 shtator 2021, konfidencial (versioni i redaktuar publik u nxor po atë ditë, F00075/RED); F00105, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës*, 10 nëntor 2021, konfidencial (versioni i redaktuar publik u nxor po atë ditë, F00105/RED); F00133, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës*, 28 janar 2022, konfidencial (versioni i redaktuar publik u nxor po atë ditë, F00133/RED).

¹⁰ KSC-BC-2020-04, IA003/F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 11 shkurt 2022, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u nxor po atë ditë, IA003/F00005/RED.

Belgjika ishte e gatshme dhe e aftë të zbatonte kushtet e propozuara nga z. Shala apo ndonjë kusht tjetër shtesë.¹¹

7. Më 14 shkurt 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, në vijim të Vendimit të Dytë të Gjykatës së Apelit: (i) urdhëroi Administratoren që të bënte parashtrime për regjimin e paraburgimit në objektin e paraburgimit të DHS-së; (ii) ftoi Mbrojtjen që të kërkonte informacion nëse Belgjika ishte e gatshme dhe e aftë të zbatonte ndonjë nga kushtet e propozuara të lirimimit që ka propozuar dhe/ose ndonjë kusht tjetër shtesë; dhe (iii) urdhëroi Mbrojtjen që të paraqiste parashtrimet e veta për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Shala deri jo më vonë se 2 marsi 2022 dhe, në të njëjtat parashtrime, të trajtonte çdo përgjigje të marrë nga Belgjika dhe parashtrimet e lartpërmendura të Zyrës Administrative (“Urdhri i 14 Shkurtit 2022”).¹²

8. Më 22 shkurt 2022, Zyra Administrative dorëzoi parashtrimet e lartpërmendura në pajtim me Urdhrin e 14 Shkurtit 2022 (“Parashtrimet e Zyrës Administrative”).¹³

9. Më 4 mars 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, pas kërkesës së Mbrojtjes për ndryshimin e afatit kohor të përcaktuar në Urdhrin e 14 Shkurtit 2022 dhe duke ditur se z. Shala ka hequr dorë nga e drejta e tij për rishikimin e paraburgimit para përfundimit të afatit dymujor të përcaktuar në nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores,¹⁴ urdhëroi Mbrojtjen që të paraqiste parashtrimet e veta për rishikimin e paraburgimit të z. Shala jo më vonë se 30 mars 2022, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores.¹⁵

¹¹ Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 54-57, 60, 61.

¹² KSC-BC-2020-04, F00145, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër drejtuar Administratores për Dorëzim Informacioni mbi Regjimin e Paraburgimit dhe për Parashtrime lidhur me Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës*, 14 shkurt 2022, publik, para. 9-11, me Shtojcën 1, publike.

¹³ KSC-BC-2020-04, F00152, Administratorja, *Parashtrime të Zyrës Administrative në Përputhje me Urdhrin për Dorëzim Informacioni mbi Kushtet e Paraburgimit (F00145)*, 22 shkurt 2022, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 22 prill 2022, F00152/RED.

¹⁴ KSC-BC-2020-04, F00160, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes për Zgjatje të Afatit për Parashtrimet për Rishikimin e Ardhshëm të Paraburgimit*, 1 mars 2022, publik, para. 2, 8-11.

¹⁵ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 4 mars 2022, publik, f. 189-190.

10. Më 30 mars 2022, Mbrojtja dorëzoi parashtrimet e veta në lidhje me rishikimin e paraburgimit të z. Shala ("Parashtrimet e Mbrojtjes").¹⁶ Zyra e Prokurorit të Specializuar u përgjigj më 7 prill 2022 ("Përgjigja").¹⁷ Mbrojtja u kundërpërgjigj më 12 prill 2022 ("Kundërpërgjigja").¹⁸

11. Më 14 prill 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi Mbrojtjen dhe/ose Administratoren, sipas rastit, që të dorëzonin për përfshirje në dokumentacion çdo korrespondencë që ka pasur me autoritetet belge lidhur me gatishmërinë dhe aftësinë e Belgjikës për të zbatuar kushtet për lirim të z. Shala.¹⁹ Administratorja dorëzoi korrespondencën e lartpërmendur më 19 prill 2022 ("Korrespondenca me Autoritetet Belge").²⁰

II. PARASHTRIMET

12. Mbrojtja kërkon nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake që t'i japë fund mbajtjes në paraburgim të z. Shala dhe të urdhërojë lirim të tij të përkohshëm, në varësi të kushteve që mund të gjykohen të nevojshme.²¹ Mbrojtja parashtron se: (i) ZPS-ja nuk ka demonstruar ekzistencën e rreziqeve të pretenduara sipas nenit 41(6) të Ligjit dhe çfarëdo kriteri që do të përligjte vazhdimin e paraburgimit të të akuzuarit; dhe (ii) zgjatja e paraburgimit të z. Shala nuk është as e nevojshme dhe as proporcionale.²²

¹⁶ KSC-BC-2020-04, F00171, Mbrojtësi i Specializuar, *Parashtrime të Mbrojtjes mbi Rishikimin e Paraburgimit dhe Përgjigje ndaj Urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 30 mars 2022, konfidencial.

¹⁷ KSC-BC-2020-04, F00177, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë për Rishikimin e Pestë të Paraburgimit*, 7 prill 2022, konfidenciale.

¹⁸ KSC-BC-2020-04, F00184, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj 'Parashtrimeve të Prokurorisë për Rishikimin e Pestë të Paraburgimit'*, 12 prill 2022, konfidenciale.

¹⁹ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 14 prill 2022, konfidencial, f. 248-249, 296.

²⁰ KSC-BC-2020-04, F00185, Administratorja, *Përcjellje e Korrespondencës*, 19 prill 2022, publike, me dy Shtojca, konfidenciale.

²¹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 1, 5, 25.

²² Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 2-3.

13. Sipas ZPS-së, mbajtja në paraburgim e të akuzuarit vazhdon të jetë e nevojshme dhe proporcionale.²³ ZPS-ja parashtron se ndërkohë nuk ka pasur fakte apo rrethana të reja që mund të ndryshonin konstatimet e arritura në Vendimin e Katërt për Paraburgimin.²⁴

14. Në Kundërpërgjigje, Mbrojtja përsërit kërkesën e vet për t'i dhënë fund paraburgimit të z. Shala dhe urdhërimin e lirimit të tij të përkohshëm me kushtet që mund të gjykohen të nevojshme.²⁵

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

15. Neni 41(6) i Ligjit parasheh se DHS-ja urdhëron paraburgimin e një personi vetëm kur ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer vepër penale brenda juridiksionit të DHS-së, dhe ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se personi: (i) paraqet rrezik për arratisje; (ii) do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë prova të veprës penale, ose rrethana konkrete tregojnë se personi do të pengojë ecurinë e procedurës penale; ose (iii) do ta përsërisë veprën penale, do të përfundojë një vepër penale në tentativë, ose do të kryejë një vepër penale që ai ose ajo e ka kërcënuar se do ta kryejë.

16. Neni 41(10) i Ligjit parasheh se, deri në momentin që aktgjykimi merr formë të prerë ose deri në lirimin nga paraburgimi, me kalimin e dy (2) muajve pas vendimit të fundit për mbajtje në paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose Trupi Gjykses i ngarkuar me çështjen shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim dhe nxjerr vendimin për vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit. Kjo parashikohet edhe në rregullën 57(2) të Rregullores.

²³ Përgjigja, para. 1.

²⁴ Përgjigja, para. 1, 3-4, 7.

²⁵ Kundërpërgjigja, para. 8.

17. Neni 41(12) i Ligjit përcakton se, krahas mbajtjes në paraburgim, mund të urdhërohen masat në vijim për të siguruar praninë e të akuzuarit, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale apo për të siguruar kryerjen me sukses të procesit penal: fletëthirrja, arrestimi, dorëzania, arresti shtëpiak, premtimi për të mos u larguar nga vendbanimi, ndalimi për t'iu afruar vendeve ose personave të caktuar, paraqitja në një stacion policor apo vend tjetër, dhe masa alternative shmangëse.

18. Në përputhje me rregullën 56(2) të Rregullores, Paneli siguron që personi të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes gjyqësore dhe, në rast të ndonjë vonese të paarsyeshme të shkaktuar nga Prokurori i Specializuar, Paneli, pas dëgjimit të palëve, mund ta lirojë personin me kushte që i gjykon të përshtatshme.

IV. DISKUTIM

19. Në këtë vendim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake: do të shqyrtojë Vendimin e Tretë për Paraburgimin të kthyer për rishikim nga Gjykata e Apelit; dhe (ii) do të bëjë rishikimin e rregullt të paraburgimit të z. Shala në pajtim me nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores.

A. STANDARDI I ZBATUESHËM

20. Mbrojtja fton Gjykatësin e Procedurës Paraprake që të shqyrtojë nevojën për vazhdimin e paraburgimit në bazë të fakteve dhe rrethanave të kësaj çështjeje.²⁶ Mbrojtja parashtron se paraburgimi i z. Shala duhet të përdoret vetëm si mundësi e fundit në raste të jashtëzakonshme dhe se supozimi në favor të lirimit të z. Shala në pritje të gjykimit duhet të përbëjë bazën e çdo vlerësimi për çdo rrezik të identifikueshëm dhe çdo rrezik i identifikueshëm nuk duhet të bazohet thjesht në

²⁶ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 4.

mundësinë, ose në supozime hamendësuese.²⁷ Gjithashtu, Mbrojtja është e mendimit se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të shqyrtojë arsyetimin e pretenduar për paraburgimin e zgjatur të z. Shala duke pasur parasysh rregullën 56(2) të Rregullores, e cila përcakton se i akuzuari nuk duhet të mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme dhe se veprimi parandalues për të penguar paraburgimin e paarsyeshëm i është kushtuar rëndësia e duhur.²⁸

21. Më tej, Mbrojtja fton Gjykatësin e Procedurës Paraprake t'i kërkojë ZPS-së që të dëshmojë ekzistencën e rreziqeve konkrete që paraqiten nga mundësia e lirit të përkohshëm.²⁹ Mbrojtja parashtron se sa më gjatë të qëndrojnë në paraburgim z. Shala, aq më i madh është dhe detyrimi i ZPS-ës për të përligjur vazhdimin e paraburgimit, ndërkohë që nuk është detyra e z. Shala që të dëshmojë se ekzistojnë arsye që përligjin lirin e tij.³⁰

22. Gjithashtu Mbrojtja thekson nuk ekziston asnjë kriter që thotë se duhet të ketë ndryshim të rrethanave për shqyrtim të thelluar dhe efektiv në lidhje me domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e vazhimit të paraburgimit të z. Shala, veçanërisht pas një periudhe të tejzgjatur të paraburgimit.³¹ Mbrojtja parashtron se kriteri që duhet aplikuar është nëse është vërtetuar ndonjë nga rreziqet konkrete sipas nenit 41(6) të Ligjit dhe nëse këto rreziqe mund të zvogëlohen me vendosjen e kushteve të përshtatshme.³²

23. ZPS-ja përgjigjet se, për rishikimin e paraburgimit sipas rregullës 57(2) të Rregullores, duhet të rishikohen arsyet ose rrethanat që mbështesin paraburgimin për të përcaktuar nëse këto arsye vazhdojnë të ekzistojnë sipas nenit 41(6) të Ligjit.³³ Për mendimin e ZPS-së, përcaktimi lidhet në mënyrë të pashmangshme me ndryshimin e

²⁷ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 3, 17, 21.

²⁸ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 18.

²⁹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 4.

³⁰ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 4, 21.

³¹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 20.

³² Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 20.

³³ Përgjigja, para. 3.

rrethanave, nëse ka ndonjë ndryshim të tyre, që nga vendimi i fundit për paraburgimin.³⁴ Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka detyrimin të bëjë konstatime në lidhje me faktorë që tashmë janë vendosur në vendimin e parë për paraburgimin.³⁵

24. Mbrojtja përgjigjet se qëndrimi i ZPS-së e përmbys detyrimin e provës, sipas të cilit ZPS-ja duhet të justifikojë vazhdimin e paraburgimit, dhe zhvlerëson qëllimin e vazhdimin të rishikimit të rregullt dymujor të paraburgimit në përputhje me rregullën 57(2) të Rregullores.³⁶ Mbrojtja shton se, në vend të kësaj, ZPS-ja duket se trajton standardin për rishqyrtim sipas rregullës 57(2) të Rregullores.³⁷

25. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, sipas nenit 41(10) të Ligjit, ai ka detyrimin të shqyrtojë nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim, përfshirë arsyet e përcaktuara në nenin 41(6) të Ligjit, konkretisht nëse: (i) ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer veprën ose veprat penale; dhe (ii) ka arsye të artikulueshme për të besuar se ekziston ndonjë nga rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.³⁸ Detyrimi për të përcaktuar nëse ekzistojnë ende rrethanat mbi të cilat mbështetet paraburgimi i imponon panelit kompetent detyrën që të vlerësojë, *propriu motu*, nëse në kohën e rishikimit dhe në rrethanat konkrete të çështjes kur bëhet rishikimi, është ende i bindur se paraburgimi i të akuzuarit vazhdon të jetë i përligjur.³⁹ Ndonëse rishikimi i rregullt çdo dy muaj sipas rregullës 57(2) të Rregullores nuk kufizohet rreptësisht me ndryshimin apo jo të rrethanave, një ndryshim i tillë, megjithatë, mund të jetë përcaktues dhe duhet të merret parasysh

³⁴ Përgjigjja, para. 3.

³⁵ Përgjigjja, para. 3.

³⁶ Kundërpërgjigjja, para. 3.

³⁷ Kundërpërgjigjja, para. 3.

³⁸ KSC-BC-2020-07, IA002-F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit* ("Apeli i Paraburgimit të Haradinajt"), 9 shkurt 2021, publik, para. 55; Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 16.

³⁹ KSC-BC-2020-06, IA006-F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit* ("Apeli i Paraburgimit të Krasniqit"), 1 tetor 2021, konfidencial, para. 15 (Versioni i redaktuar publik u nxor po atë ditë, IA006/F00005/RED); Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 17.

nëse ngrihet prej një pale ose *proprio motu*.⁴⁰ Paneli mund t'u referohet konstatimeve në vendimet e mëparshme, nëse është i bindur se provat ose informacionet që mbështesin ato vendime mbështesin ende konstatimet e bëra në kohën e shqyrtimit.⁴¹ Nuk kërkohet të bëhen konstatime në lidhje me faktorët që tashmë janë vendosur në vendimin e parë për paraburgimin dhe as të shqyrtohen parashtrime të cilat thjesht përsërisin argumente që tashmë janë trajtuar në vendimet e mëparshme.⁴² ZPS-ja ka detyrimin e vërtetimit se paraburgimi i të akuzuarit është i domosdoshëm.⁴³ Kjo do të thotë se, në kohën e rishikimit, ZPS-ja duhet të paraqesë argumente specifike dhe prova konkrete për të provuar se vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm.

26. Në kundërshtim nga argumenti i Mbrojtjes, parimet e përfshira në paragrafin e mësipërm përcaktojnë qartë se detyrimi i provës i takon ZPS-së dhe Përgjigjja nuk përcakton ndryshe.⁴⁴ Për më tepër, këto parime janë përcaktuar qartë në jurisprudencë dhe nuk e zhvlerësojnë garancinë sipas nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores.⁴⁵

B. DYSHIMI I BAZUAR

27. Sa i përket standardit për vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(a) i Ligjit së pari kërkon ekzistencën e dyshimit të bazuar se personi i paraburgosur ka kryer një vepër penale brenda juridiksionit të DHS-së. Ky është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimin të paraburgimit të personit të paraburgosur.⁴⁶

⁴⁰ Apeli i Paraburgimit të *Krasniqit*, para. 16; Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 18.

⁴¹ Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 18.

⁴² Apeli i Paraburgimit të *Haradinajt*, para. 55; Apeli i Paraburgimit të *Krasniqit*, para. 17; Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 18.

⁴³ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 13, me referenca shtesë.

⁴⁴ *Shih gjithashtu* Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 15.

⁴⁵ Faktikisht, një kundërshtim i ngjashëm i Mbrojtjes kundër jurisprudencës së Gjykatës së Apelit u refuzua kohët e fundit, *shih* Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 15-18.

⁴⁶ *Po kështu* ECtHR, *Merabishvili v. Georgia* [GC], no. 72508/13, [Judgment](#), 28 November 2017, para. 222, me referenca të mëtejshme.

28. Mbrojtja, ndërsa u qëndron parashtrimeve të saj të mëparshme mbi paligjshmërinë e vazhdimit të paraburgimit të z. Shala,⁴⁷ nuk e trajton në mënyrë specifike këtë kriter.

29. ZPS-ja përgjigjet se, për arsyet e shtjelluara në Vendimin e Konfirmimit dhe Vendimin e Katërt për Paraburgimin, vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar mirë se i akuzuari ka kryer një numër veprash penale që përfshihen në juridiksionin e DHS-së, duke e tejkalar kështu standardin e dyshimit të bazuar që kërkohet sipas nenin 41 të Ligjit.⁴⁸ ZPS-ja shton se nuk ka pasur asnjë zhvillim të ri që mund ta ndryshojë këtë konstatim ose të garantojë rishqyrtimin e tij nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ndërkohë që [REDAKTUAR] vërtetojnë më tej tërësinë e provave mbi të cilat u mbështet Gjykatësi i Procedurës Paraprake.⁴⁹

30. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se në Vendimin e Konfirmimit konstatohet se, në përputhje me nenin 39(2) të Ligjit, ekziston dyshimi i bazuar mirë se z. Shala mban përgjegjësi penale për një numër krimesh lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme) sipas neneve 14(1)(c) dhe 16(1)(a) të Ligjit.⁵⁰ Standardi mbi të cilat u bazuan këto konstatime ishte më i lartë se ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit.⁵¹

31. Në mungesë të ndonjë informacioni apo zhvillimi të ri në lidhje me këtë vendim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se vazhdon të përmbushet kriteri i përcaktuar në nenin 41(6)(a) të ligjit.

⁴⁷ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 16.

⁴⁸ Përgjigjja, para. 4.

⁴⁹ Përgjigjja, para. 4.

⁵⁰ Vendimi i Konfirmimit, para. 140(a); *shih gjithashtu* Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 15; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 22; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 19; Vendimi i Katërt për Paraburgimin, para. 21.

⁵¹ Vendimi i Konfirmimit, para. 35; *shih gjithashtu* KSC-BC-2020-06, IA008-F00004, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit*, 1 tetor 2021, konfidencial, para. 21. Versioni i redaktuar publik u nxor po atë ditë, IA008/F00004/RED.

C. DOMOSDOSHMERËRIA E PARABURGIMIT

32. Pas përmbushjes së standardit të nenit 41(6)(a) të Ligjit, arsyet që përlligjin heqjen e lirisë së personit duhet të jenë të artikulueshme, në kuptimin që duhet të saktësohen me hollësi.⁵² Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, bazuar në provat e disponueshme, arsyet konkrete të artikulueshme duhet të mbështesin “besimin”⁵³ se ekziston ndonjë nga rreziqet e parapara në secilin prej tre nënparagrafëve të nenit 41(6)(b) të Ligjit, çka nënkupton pranimin e mundësisë, e jo të pashmangshmërisë, se ato mund të ndodhin në të ardhmen.⁵⁴ Me fjalë të tjera, standardi që duhet të zbatohet është më i ulët se pashmangshmëria, por më i lartë se thjesht mundësia që rreziku të materializohet.⁵⁵ Gjatë marrjes së vendimit nëse një person duhet të lirohet apo të mbahet në paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të shqyrtojë masat alternative për parandalimin e rreziqeve të parapara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.⁵⁶

33. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, Mbrojtja u përmbahet plotësisht parashtrimeve të veta të mëparshme në lidhje me parashtrimin se vazhdimi i paraburgimit të z. Shala është i paligjshëm dhe kërkesës së saj për lirimin e menjëhershëm të tij.⁵⁷ Siç është përcaktuar më lart dhe në vendimet e mëparshme për rishikimin e paraburgimit të z. Shala, Gjykatësit të Procedurës Paraprake nuk i kërkohet as që të bëjë konstatime në lidhje me faktorët për të cilët tashmë është vendosur në vendimin e parë për paraburgimin dhe as të shqyrtojë parashtrime të

⁵² Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 16, me referenca shtesë.

⁵³ *Shih pjesën e përgjithshme* të nenit 41(6)(b) të Ligjit.

⁵⁴ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 16, me referenca shtesë.

⁵⁵ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 16, me referenca shtesë.

⁵⁶ KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktoendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurave dhe Provave miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017*, 26 prill 2017, publik, para. 114; *shih edhe* ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], no. 23755/07, [Judgment](#), 5 July 2016 (“*Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC]”), para. 87 *in fine*; ECtHR, *Idalov v. Russia* [GC], no. 5826/03, [Judgment](#), 22 May 2012, para. 140 *in fine*.

⁵⁷ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 7, 16, 22.

cilat thjesht përsërisin argumente që tashmë janë trajtuar në vendimet e mëparshme.⁵⁸ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk do t'i shqyrtojë më tej këto parashtrime dhe, si pasojë, në pjesët vijuese do të trajtohen vetëm argumentet që nuk janë ngritur dhe shqyrtuar më parë.

1. Rreziku i arratisjes

34. Përveç përsëritjes së parashtrimeve të mëparshme,⁵⁹ Mbrojtja nuk paraqet parashtrime konkrete në lidhje me rrezikun e arratisjes. Sipas ZPS-së, rreziku i arratisjes së të akuzuarit është shtuar më shumë për shkak: (i) të ecurisë së mëtejshme të procedurave drejt fillimit të gjyimit, ku përfshihet caktimi i një date paraprake për kalimin e çështjes Trupit Gjykes; (ii) të dorëzimit të Dosjes Paraprake dhe të dokumenteve të tjera të rregullës 95(4) nga ZPS-ja, të cilat i ofrojnë të akuzuarit informacion më të hollësishëm lidhur me provat kundër tij dhe burimet e tyre dhe përfundimisht do të rezultojë në heqjen graduale të masave mbrojtëse për dëshmitarët në këtë çështje; dhe (iii) se i akuzuari së shpejti do të jetë në dijeni të identitetit [REDAKTUAR], të cilët konfirmojnë përfshirjen dhe rolin e rëndësishëm të tij në kryerjen e krimeve të paraqitura në Aktakuzën e kësaj çështjeje gjyqësore.⁶⁰

35. Pas shqyrtimit të faktorëve dhe rrethanave të përmendura në vendimet për rishikimin e paraburgimit të z. Shala, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vazhdon të jetë i bindur se ato ekzistojnë. Më konkretisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se z. Shala: (i) është në dijeni të akuzave të rënda kundër tij, të mundësisë së marrjes së një dënimi të rëndë për ato akuza në rast se shpallet fajtor, dhe të vendimit të formës së prerë për fajësinë e dy anëtarëve të ndërmarrjes kriminale të përbashkët ("NKP"), anëtar i së cilës pretendohet se ka qenë edhe ai; dhe (ii) refuzon legjitimitetin

⁵⁸ Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 24, 28, 32; Vendimi i Katërt për Paraburgimin, para. 24; Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 18.

⁵⁹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 22.

⁶⁰ Përgjigja, para. 2, 5, 6.

e DHS-së.⁶¹ Gjithashtu: (i) përmasat relativisht të vogla të grupit që përbën NKP-në e pretenduar dhe fakti se ngjarjet mbi të cilat bazohen akuzat janë lehtësisht të dallueshme, e rrisin mundësinë që anëtarët e pretenduar të tij të ndihmojnë reciprokisht njëri-tjetrin, përfshirë dhe ndihmën që mund t'i japin njëri-tjetrit për t'u arratisur; dhe (ii) ekziston një kontekst i përgjithshëm i një atmosfere të përgjithshme, të rrënjosur dhe të vazhdueshme të ndërhyrjes në proceset penale që kanë lidhje me Ushtrinë Çlirimtare Kosovare ("UÇK") dhe të frikësimit të dëshmitarëve.⁶² Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se, në kundërshtim me parashtrimin e ZPS-së, rreziku i arratisjes nuk është rritur për shkak të ecurisë së mëtejshme të procedurave, duke pasur parasysh se faktorët dhe rrethanat e lartpërmendura nuk varen nga zhvillime të tilla. Për këto arsye, aktualisht vazhdon të ekzistojë një rrezik i moderuar që z. Shala të arratiset.

2. Rreziku i pengimit të ecurisë së procedurave të DHS-së

36. Përveç përsëritjes së parashtrimeve të saj të mëparshme,⁶³ Mbrojtja nuk paraqet parashtrime konkrete në lidhje me rrezikun e pengimit në Parashtrimet e Mbrojtjes. Argumentet e paraqitura nga ZPS-ja në Përgjigjen e vet jepen me hollësi më lart, në lidhje me rrezikun e arratisjes.⁶⁴ Mbrojtja kundërpërgjigjet se asnjë nga faktorët e përmendur nga ZPS-ja nuk tregon rrezik për pengimin e procesit ose kryerjen e krimeve të mëtejshme.⁶⁵ Mbrojtja shton se, parashtrimi i ZPS-së se secili nga rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) është shtuar që nga rishikimi i fundit mbi vazhdimin e paraburgimit për shkak të ecurisë së procedurave, është qartësisht i pamjaftueshëm,

⁶¹ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 24-25; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 28; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 25; Vendimi i Katërt për Paraburgimin, para. 27.

⁶² Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 26; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 28; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 25; Vendimi i Katërt për Paraburgimin, para. 27.

⁶³ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 22.

⁶⁴ *Shih* para. 34 më lart.

⁶⁵ Kundërpërgjigja, para. 4.

pasi e drejta themelore për liri kërkon që supozimi të shkojë në dobi të lirisë së personit.⁶⁶

37. Rikujtojmë se: (i) [REDAKTUAR];⁶⁷ dhe (ii) ekzistenca e masave mbrojtëse nuk bie ndesh me konstatimin se ekziston rreziku i pengimit në rrethanat e kësaj çështjeje dhe, në përgjithësi, domosdoshmëria e masave të tilla demonstroi rrezikun e shtuar duke pasur parasysh se ngjarjet mbi të cilat mbështeten akuzat janë lehtësisht të dallueshme.⁶⁸

38. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton më tej se, [REDAKTUAR], ecurinë e mëtejshme të fazës paraprake të procedurave pas Vendimit të Katërt për Paraburgimin – veçanërisht, dorëzimin e Dosjes Paraprake të ZPS-së,⁶⁹ si edhe nxjerrjen e afërt të identitetit [REDAKTUAR]⁷⁰ - e shton rrezikun e pengimit, pasi do t'i ofrojë z. Shala informacion më të hollësishëm lidhur me provat kundër tij dhe përfundimisht do të rezultojë në heqjen e disa masave mbrojtëse.⁷¹

39. Argumentet e Mbrojtjes në Kundërpërgjigje i keqinterpretojnë standardin që zbatohet për rishikimin e paraburgimit. Mbrojtja nuk merr parasysh faktin se rreziku i pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së vazhdon të ekzistojë për arsye se [REDAKTUAR], ndërkohë që për disa zhvillime në lidhje me këtë çështje gjyqësore është konstatuar se e shtojnë këtë rrezik. Rrjedhimisht, nuk mund të thuhet se konstatimi i lartpërmendur varet ekskluzivisht nga ecuria e çështjes dhe, për pasojë,

⁶⁶ Kundërpërgjigja, para. 5-7.

⁶⁷ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 32-35; Vendimi i Parë i Gjykatës së Apelit, para. 35-42; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 32; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 29; Vendimi i Katërt për Paraburgimin, para. 30; Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 33.

⁶⁸ Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 31; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 29; Vendimi i Katërt për Paraburgimin, para. 31; Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 32, 34.

⁶⁹ KSC-BC-2020-04, F00135/A01, *Prokurori i Specializuar*, Dosja Paraprake e Prokurorisë, 28 janar 2022, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 31 janar 2022, F00136/A01; versioni konfidencial me më pak redaktime u dorëzua më 8 shkurt 2022, F00139/A01).

⁷⁰ KSC-BC-2020-04, F00169, *Prokurori i Specializuar*, *Kërkesë e Prokurorisë sipas Rregullës 102(2) dhe për Ndryshimin e Listës së Dëshmitarëve dhe të Provave Materiale të ZPS-së*, 25 mars 2022, konfidencial (Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 28 mars 2022, F00169/RED); KSC-BC-2020-04, Transkripti, 14 prill 2022, konfidencial, f. 272-273.

⁷¹ *Shih gjithashtu* Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 35-38.

parashtrimi se këta faktorë janë të pamjaftueshëm është i gabuar. Për këto arsye, argumentet e Mbrojtjes hidhen poshtë.

40. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se rreziku i pengimit të procedurave të DHS-së nga z. Shala vazhdon të ekzistojë për faktin se [REDAKTUAR] dhe se me ecurinë e fazës paraprake të procedurave z. Shala po njihet gjithnjë e më shumë me provat kundër tij.

3. Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera

41. Përveç përsëritjes së parashtrimeve të saj të mëparshme,⁷² Mbrojtja nuk paraqet parashtrime konkrete në lidhje me rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera në Parashtrimet e Mbrojtjes. Argumentet e parashtruara nga ZPS-ja në Përgjigjen e vet janë përshkruar me hollësi më lart, në lidhje me rrezikun e arratisjes.⁷³ Argumentet e parashtruara nga Mbrojtja në Kundërpërgjigje janë përshkruar më lart, në lidhje me rrezikun e pengimit.⁷⁴

42. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh faktin se ekzistenca e rrezikut të pengimit të procesit nuk nënkupton automatikisht rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera, por përsërit se, në këtë çështje gjyqësore, faktorët mbi të cilët mbështetet rreziku i parë janë me rëndësi edhe për vlerësimin e këtij të fundit.⁷⁵ Sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, rreziku që z. Shala të kryejë krime të tjera vazhdon të ekzistojë, duke pasur parasysh se [REDAKTUAR].⁷⁶ Gjithashtu, ashtu si me rrezikun e pengimit të procesit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se, me ecurinë e fazës paraprake të procedurave që nga Vendimi i Katërt për Paraburgimin,

⁷² Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 22.

⁷³ *Shih* para. 34 më lart.

⁷⁴ *Shih* para. 36 më lart.

⁷⁵ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 39; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 36; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 33; Vendimi i Katërt për Paraburgimin, para. 35.

⁷⁶ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 39; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 36; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 33; Vendimi i Katërt për Paraburgimin, para. 35.

veçanërisht me dorëzimin e Dosjes Paraprake nga ZPS-ja dhe nxjerrjen e pritshme të identitetit [REDAKTUAR], shtohet rreziku që z. Shala të kryejë krime të tjera.⁷⁷ Argumentet e Mbrojtjes se faktorët e përmendur nga ZPS-ja janë të pamjaftueshëm nuk merren parasysh për të njëjtat arsye të identifikuara më lart.⁷⁸ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se rreziku që z. Shala të kryejë krime të tjera aktualisht vazhdon të ekzistojë.

4. Përfundim

43. Në kuadër të rishikimit të rregullt të paraburgimit të z. Shala në përputhje me nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdojnë të ekzistojnë rreziqet që z. Shala të arratiset, të pengojë ecurinë e procedurave të DHS-së, ose të kryejë krime të tjera kundër atyre që perceptohen se janë kundër UÇK-së, përfshirë dëshmitarët që kanë dhënë dëshmi për ZPS-së dhe/ose pritet të paraqiten para DHS-së. Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vijim do të vlerësojë nëse këto rreziqe mund të trajtohen si duhet me anë të vendosjes së kushteve për lirimin e përkohshëm të z. Shala.

D. LIRIMI ME KUSHT

44. Mbrojtja përsërit kërkesën e saj për lirimin e menjëhershëm të z. Shala, në varësi të kushteve të propozuara më parë ose kushteve që konsiderohen të përshtatshme, dhe përsërit se z. Shala është i gatshëm të marrë zotime të shumta dhe t'u nënshtrohet këtyre kushteve të gjykuara të përshtatshme nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.⁷⁹ Mbrojtja shton se, pasi pyeti qeverinë e Belgjikës në lidhje me gatishmërinë dhe mundësinë e saj për të zbatuar kushtet e lirimimit të propozuara nga Mbrojtja, Ministria Federale e Drejtësisë e Belgjikës [REDAKTUAR].⁸⁰ Për rrjedhojë, Mbrojtja nuk i kërkon

⁷⁷ Shih para. 38 më lart.

⁷⁸ Shih para. 39 më lart.

⁷⁹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 5, 24, 25.

⁸⁰ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 6, 15.

Gjykatësit të Procedurës Paraprake që ta shqyrtojë opsionin e [REDAKTUAR], pa paragjykuar aspekte të tjera.⁸¹

45. ZPS-ja parashtron se këto rreziqe mund të zvogëlohen dhe menaxhohen në mënyrë efektive vetëm me anë të vazhdimit të paraburgimit të të akuzuarit në objektin e paraburgimit të DHS-së.⁸² ZPS-ja shton se, në bazë të parashtrimeve të Zyrës Administrative, monitorimi dhe kufizimi i komunikimeve që mund të zbatohen nga oficerët tejet të përgatitur të paraburgimit në objektin e paraburgimit të DHS-së, janë veçanërisht të përshtatshëm për eliminimin e rreziqeve të identifikuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe, po ashtu, në çdo kohë mund të vendosen kufizime të veçanta *ad hoc*, nëse gjykohet e nevojshme nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose Trupi Gjykses.⁸³ Gjithashtu, ZPS-ja është e mendimit se asnjë nga këto masa nuk mund të aplikohet dhe të zbatohet në mënyrë efektive jashtë objektit të paraburgimit të DHS-së, sidomos pas refuzimit të autoriteteve belge për të zbatuar kushtet e lirit të propozuara nga Mbrojtja.⁸⁴

46. Për sa i takon rrezikut të arratisjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se më parë ka konstatuar se kushtet e propozuara në lidhje me Vendimin e Parë për Paraburgimin, konkretisht, zotimet e z. Shala për t'iu nënshtruar kontrolleve të përditshme të zyrtarëve të autorizuar belge, për të dorëzuar të gjitha dokumentet e udhëtimit dhe për t'iu nënshtruar monitorimit të rreptë të autoriteteve belge, e zvogëlojnë mjaftueshëm këtë rrezik.⁸⁵ Duke marrë parasysh se parashtrimet e përgjithshme të ZPS-së në lidhje me këtë çështje nuk mbështeten në prova, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, në mungesë të një informacioni apo zhvillimi të

⁸¹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 7.

⁸² Përgjigjja, para. 8, 10.

⁸³ Përgjigjja, para. 9.

⁸⁴ Përgjigjja, para. 9.

⁸⁵ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 45; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 40; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 37; Vendimi i Katërt për Paraburgimin, para. 39.

ri në lidhje me këtë vendim, kushtet e lartpërmendura mbetet të përshtatshme për të zvogëluar rrezikun e arratisjes së z. Shala.

47. Në lidhje me rrezikun e pengimit të ecurisë së procedurave të DHS-së dhe të kryerjes së krimeve të tjera, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ndonëse vuri në dukje se kushtet e propozuara nga Mbrojtja janë trajtuar më parë dhe për këtë arsye nuk ka nevojë të shqyrtohen më tej,⁸⁶ rikujton se është vendosur që: (i) këto kushte nuk trajtojnë mundësinë që z. Shala të përdorë pajisje komunikimi që u përkasin të tjerëve ose t'u kërkojë të tjerëve të përdorin pajisjet e tyre për këtë qëllim; dhe (ii) kushtet e zbatimit janë të pamjaftueshme për të siguruar monitorimin efektiv të komunikimeve të z. Shala.⁸⁷ Nuk ka ndonjë informacion apo zhvillim të ri që do të justifikonte ndryshimin e këtyre konstatimeve, veçanërisht sepse Mbrojtja nuk specifikon parashtrimin e përgjithshëm të saj se mund të vendosen masa të përshtatshme.⁸⁸

48. Për më tepër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, pavarësisht pyetjes nëse mundësia e arrestit shtëpiak do të zvogëlonte mjaftueshëm rreziqet e lartpërmendura, kjo masë nuk mund të zbatohet, duke pasur parasysh përgjigjen e autoriteteve belge se [REDAKTUAR].⁸⁹

49. Në të njëjtën kohë, Parashtrimet e Zyrës Administrative konfirmojnë se masat e vendosura në objektin e paraburgimit të DHS-së, të para në tërësi, ofrojnë garanci të forta kundrejt vizitave dhe komunikimeve të pamonitoruara me anëtarët e familjes dhe vizitorët e miratuar paraprakisht, me synimin për të zvogëluar sa më shumë rrezikun e pengimit dhe të kryerjes së veprave penale të tjera, duke pasur parasysh se: (i) të gjitha bisedat telefonike jo të mbrojtura të të paraburgosurve mbikëqyren në mënyrë pasive; (ii) nëse është e domosdoshme dhe proporcionale, Administratorja

⁸⁶ Apeli i Paraburgimit të *Haradinajt*, para. 55; Apeli i Paraburgimit të *Krasniqit*, para. 17.

⁸⁷ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 46-48; Vendimi i Parë i Gjykatës së Apelit, para. 53-58, 61; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 41-42; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 38; Vendimi i Katërt për Paraburgimin, para. 40.

⁸⁸ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 24.

⁸⁹ Shtojca 2 e Korrespondencës me Autoritetet Belge, f. 2.

mund të vendosë për monitorimin aktiv të bisedave telefonike për një periudhë të kufizuar, deri në tridhjetë ditë kalendarike të njëpasnjëshme, që mund të rinovohet me një periudhë shtesë deri në tridhjetë ditë kalendarike të njëpasnjëshme, ose për dëgjimin e incizimit të bisedës; (iii) komunikimet e pamonitoruara janë rreptësisht të kufizuara, duke pasur parasysh se të paraburgosurve u lejohen “vizita private” të pamonitoruara vetëm për disa anëtarë të ngushtë të familjes dhe brenda periudhave të shkurtra kohore; (iv) vizitat personale dhe me video, si rregull, bëhen brenda rrezes së shikimit dhe dëgjimit të përgjithshëm të oficerëve të objektit të paraburgimit të DHS-së, dhe gjithashtu, Administratorja mund të vendosë masa mbrojtëse shtesë për vizita të tilla, përfshirë monitorimin aktiv dhe dëgjimin e incizimit të bisedës; (v) e gjithë korrespondenca i nënshtrohet kontrolleve të sigurisë; (vi) mund të zbatohen kufizime të tjera në lidhje me vizitat (si me video ashtu edhe personale), bisedat telefonike dhe korrespondencën; (vii) nëse një komunikim shqetësues ka të bëjë me mbrojtjen e mirëqenies, sigurisë, të drejtave dhe lirive të të tjerëve [REDAKTUAR]; dhe (viii) objekti i paraburgimit të DHS-së është objekt i sigurisë së lartë, dhe oficerët tejet të kualifikuar të objektit të paraburgimit të DHS-së [REDAKTUAR] dhe bëjnë trajnime për zbatimin e kushteve të vizitave dhe të komunikimit në objektin e paraburgimit të DHS-së.⁹⁰ Masat e lartpërmendura, si edhe masa të tjera, mund të urdhërohen *proprio motu* nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në pajtim me rregullën 56(6) të Rregullores. Në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se Administratorja dhe Paneli, që kanë qasje të pakufizuar në informacionin konfidencial lidhur me dëshmitarët dhe viktimat, mund të ndërmarrin veprime më shpejt se autoritetet e tjera që veprojnë sipas një kornize të ndryshme.⁹¹

⁹⁰ Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 17-47; *shih gjithashtu* Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 53; KSC-BC-2020-06, IA014-F00008, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit Lidhur me Rishqyrtimin e Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin dhe Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit*, 31 mars 2022, konfidencial, para. 38, 41, 44 (“Apeli i Paraburgimit të Veselit i 31 marsit 2022”) (Versioni i redaktuar publik u nxor po atë ditë, IA014/F00008/RED).

⁹¹ *Shih gjithashtu mutatis mutandis* Apeli i Paraburgimit të Veselit i 31 marsit 2022, para. 41.

50. Sa i përket vendosjes së kushteve të tjera, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se Gjykata e Apelit ka specifikuar se duhet të shqyrtohen të gjitha kushtet *e arsyeshme* që mund t'i vendosen një të akuzuari.⁹² Në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr parasysh se përgjigja e autoriteteve belge [REDAKTUAR], detyrimisht nënkupton se nuk është e mundur të vendoset as ndonjë kusht tjetër që është i arsyeshëm dhe mund të zvogëlojë mjaftueshëm rreziqet ekzistuese. Megjithatë, siç është konstatuar më parë, kushtet e mëtejshme, si vizitat e monitoruara nga autoritetet belge, janë veçanërisht të rëndësishme për faktin se z. Shala ka aftësinë për të komunikuar në një gjuhë që nuk është gjuhë zyrtare në Belgjikë.⁹³ Për më tepër, duke pasur parasysh shkallën e rëndë të rreziqeve të përmendura më lart, çfarëdo masash të tjera që nuk janë arrest shtëpiak me kushte shoqëruese mjaftueshmërisht të ngjashme me rregullat në objektin e paraburgimit të DHS-së, do të ishin të pamjaftueshme ose do të ishin aq jopraktike sa do të bëheshin të paarsyeshme. Për këto arsye Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se nuk ka kushte të tjera për të zvogëluar në masën e duhur rreziqet ekzistuese.

51. Së fundi, ritheksohet se Gjykata e Apelit ka konstatuar se, duke qenë se bëhet fjalë për lirinë e një individi, mungesa e garancive paraprake nga një shtet i tretë nuk e pengon një panel që të kërkojë informacion nga ai shtet në qoftë se Mbrojtja ose, në përgjithësi, palët, nuk kanë arritur të marrin garancitë e përmendura, ose në qoftë se informacioni i dhënë nga ai shtet nuk mjafton për t'i mundësuar panelit të marrë vendim të bazuar në informacion.⁹⁴ Për këtë arsye, Mbrojtja dhe/ose Administratorja u urdhëruan të dorëzonin çdo korrespondencë me Belgjikën në dokumentacion e çështjes, në mënyrë që të vlerësohet nëse ka nevojë për t'iu drejtuar përsëri autoriteteve kompetente belge. Ndërsa është i vetëdijshëm për të drejtën themelore

⁹² KSC-BC-2020-06, IA017-F00011, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit*, 5 prill 2022, konfidencial, para. 51 (theksimi në origjinal) (Versioni i redaktuar publik u nxor po atë ditë, IA017/F00011/RED).

⁹³ Vendimi i Katërt për Paraburgimin, para. 40.

⁹⁴ Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 57.

për liri, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se në kuadër të këtij vendimi nuk kërkohet informacion i mëtejshëm nga Belgjika, duke pasur parasysh faktin se: (i) Belgjikës i është kërkuar shprehimisht që të paraqesë pikëpamjet e veta për çështjet nën shqyrtim dhe ajo bëri kategorikisht të ditur se [REDAKTUAR]; (ii) Mbrojtjes i është dhënë mundësia që të dorëzojë parashtrimet e veta në këtë çështje dhe ajo vendosi që të mos e ftojë Gjykatësin e Procedurës Paraprake për të shqyrtuar më tej mundësinë e arrestit shtëpiak; (iii) Mbrojtja nuk specifikon se si kushtet e tjera mund t'i zvogëlonin mjaftueshëm rreziqet ekzistuese; (iv) rreziqet e identifikuara më lart janë të rënda dhe vazhdojnë të ekzistojnë; dhe (v) masat që nuk kanë të bëjnë me arrestin shtëpiak me kushte shoqëruese janë të pamjaftueshme për t'i trajtuar këto rreziqe.

52. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vazhdon të jetë i bindur se komunikimet e z. Shala mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rreziqet e lartpërmendura vetëm nëpërmjet zbatimit të kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të DHS-së. Në përputhje me sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kushtet e propozuara, dhe çdo kusht tjetër i vendosur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, janë të pamjaftueshme për të zvogëluar rrezikun që z. Shala të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së ose të kryejë krime të tjera. Për rrjedhojë, Vendimi i Tretë për Paraburgimin, lidhur me aspektet e kthyera nga Gjykata e Apelit për rishqyrtim, konfirmohet. Ky përfundim vlen, për të njëjtat arsye, edhe për rishikimin e tanishëm të rregullt të paraburgimit të z. Shala në pajtim me nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores.

E. PROPORCIONALITETI I PARABURGIMIT

53. Mbrojtja parashtron se paraburgimi i z. Shala është joproportional duke pasur parasysh: (i) kohëzgjatjen e paraburgimit, konkretisht 379 ditë; (ii) shkallën e çështjes gjyqësore; (iii) mungesën e vizitave të rregullta familjare dhe pasojat financiare nga paraburgimi i tij për familjen; dhe (iv) fakti që procesi i nxjerrjes së materialeve nuk

ka përfunduar dhe se Mbrojtjes do t'i duhet kohë shtesë për të analizuar materialin e nxjerrë, për të kryer të gjitha hetimet e nevojshme dhe për të përgatitur dosjen paraprake.⁹⁵

54. ZPS-ja përgjigjet se vazhdimi i paraburgimit të të akuzuarit është proporcional sepse: (i) ndaj tij janë ngritur katër akuza për krime lufte dhe, nëse shpallet fajtor, ai mund të dënohet me burgim për kohë të gjatë; (ii) rreziqet e parapara në nenin 41(6) të Ligjit nuk mund të zvogëlohen jashtë objektit të paraburgimit të DHS-së; (iii) Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ka planifikuar tashmë paraprakisht kalimin e dosjes së çështjes Trupit Gjykses; dhe (iv) ZPS-ja ka vazhduar të përmbushë detyrimet e veta për nxjerrjen, përfshirë shqyrtimin dhe nxjerrjen e të gjitha materialeve që mund të jenë të rregullës 103 të Rregullores, me përjashtim të dokumenteve që kërkojnë masa mbrojtëse.⁹⁶

55. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson rëndësinë e parimit të proporcionalitetit në përcaktimin e arsyeshmërisë së paraburgimit dhe se, sa më gjatë një person mbahet në paraburgim, aq më i madh është detyrimi i ZPS-së për të përlegjur vazhdimin e paraburgimit.⁹⁷ Kohëzgjatja e paraburgimit në pritje të gjykimit është një faktor që duhet të merret parasysh së bashku me shkallën e rreziqeve të përshkruara në nenin 41(6)(b) të Ligjit, në mënyrë që, duke mbajtur parasysh të gjithë faktorët, të përcaktohet nëse vazhdimi i paraburgimit "ka pushuar së qeni i arsyeshëm" dhe personi duhet të lirohet.⁹⁸ Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se pyetja nëse periudha kohore e kaluar në paraburgim është e arsyeshme nuk mund të vlerësohet teorikisht. Vlerësimi nëse vazhdimi i mbajtjes së

⁹⁵ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 3, 5, 19, 23.

⁹⁶ Përgjigja, para. 1, 11.

⁹⁷ KSC-BC-2020-07, IA001/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e tij në Paraburgim*, 9 dhjetor 2020, publik, para. 72-73.

⁹⁸ *Po ashtu*, KSC-BC-2020-06, IA002/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, konfidencial, para. 69. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, IA002/F00005/RED.

të akuzuarit në paraburgim është i arsyeshëm duhet të bëhet mbi bazën e fakteve të secilës çështje gjyqësore dhe sipas veçorive të saj specifike.⁹⁹

56. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se: (i) z. Shala është mbajtur në paraburgim në Belgjikë që nga data 16 mars 2021 dhe më pas në objektin e paraburgimit të DHS-së që nga data 15 prill 2021; (ii) ndaj tij janë ngritur katër akuza për krime lufte që pretendohet se kanë ndodhur në Shqipëri gjatë disa javëve; (iii) nëse shpallet fajtor, ai mund të dënohet me burgim për kohë të gjatë; (iv) rreziqet e parapara në nenin 41(6)(b)(ii) dhe (iii) të Ligjit nuk mund të zvogëlohen me kushtet e propozuara dhe/ose kushte të tjera shtesë; (v) të gjitha veprimet e nevojshme procedurale në lidhje me fazën paraprake të kësaj çështje gjyqësore kanë përfunduar, po përfundojnë ose do të përfundojnë me synim kalimin e çështjes për gjykim në një të ardhme të afërt – në veçanti, ZPS-ja ka përfunduar, në parim, nxjerrjen e materialeve sipas rregullave 102(1)(b) dhe 103 të Rregullores ndërkohë që pothuajse ka përfunduar nxjerrjen e materialeve sipas rregullës 107 të Rregullores,¹⁰⁰ është bërë përparim i mëtejshëm në procesin e nxjerrjes së materialeve sipas rregullës 102(3) të Rregullores (konkretisht, me kërkesë të Mbrojtjes, ZPS-ja ka dorëzuar një njoftim sipas rregullës 102(3) të Rregullores me përshkrime pjesërisht të rishikuara,¹⁰¹ [REDAKTUAR],¹⁰² ZPS-ja ka përfunduar rishikimin e njoftimit të vet lidhur me provat shfajësuese në pajtim me rregullës 102(3) të Rregullores,¹⁰³ dhe ZPS-së i është dhënë leja për të ndryshuar më tej njoftimin e vet sipas rregullës 102(3) të Rregullores¹⁰⁴), dosja paraprake e ZPS-së bashkë me tabelën sipas rregullës 109(c) të Rregullores është dorëzuar,¹⁰⁵ dhe palët kanë dorëzuar pikat e tyre faktike për të cilat pajtohen;¹⁰⁶

⁹⁹ ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], para. 90.

¹⁰⁰ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 14 prill 2022, konfidencial, f. 252-253, 268, 269, 287.

¹⁰¹ KSC-BC-2020-04, F00167, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë sipas Rregullës 102(3) me Përshkrime Pjesërisht të Rishikuara*, 18 prill 2022, publik, me një Shtojcë, konfidenciale.

¹⁰² [REDAKTUAR].

¹⁰³ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 4 mars 2022, publik, p. 212.

¹⁰⁴ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 14 prill 2022, konfidencial, f. 297.

¹⁰⁵ *Shih poshtëshënimin* 69 më lart.

¹⁰⁶ KSC-BC-2020-04, F00178, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë mbi Pikat për të cilat Palët Pajtohen*, 8 prill 2022, publik, me një Shtojcë, konfidenciale.

(vi) Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka caktuar një datë paraprake për t'ia kaluar dosjen e çështjes Trupit Gjykues, përkatësisht 31 gushtin 2022, dhe ka përcaktuar afate të tjera në lidhje me disa detyrime të papërfunduara gjatë procedurës paraprake;¹⁰⁷ dhe (vii) afatet përkatëse – disa prej të cilave janë zgjatur pas paraqitjes së arsyeve të vlefshme, përfshirë edhe me kërkesë të Mbrojtjes¹⁰⁸ - janë respektuar ose po respektohen dhe çdo kërkesë tjetër për zgjatjen e afateve do të vlerësohet përkundrejt kritereve ligjore të zbatueshme. Gjithashtu, në pajtim me nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores, paraburgimi i z. Shala do të rishikohet çdo dy muaj ose kur ka ndryshim të rrethanave.

57. Lidhur me parashtrimet e Mbrojtjes në lidhje me kohëzgjatjen e paraburgimit të z. Shala, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ka vlerësuar si duhet kohën që z. Shala ka kaluar në paraburgim pas Vendimi të Katërt për Paraburgimin, përfshirë si pasojë edhe detyrimin më të madh të ZPS-së për të përligjur vazhdimin e paraburgimit të z. Shala. Megjithatë, peshuar kundrejt faktorëve të tjerë dhe, në veçanti, natyrës së rëndë të akuzave kundër z. Shala, pamundësisë së zvogëlimit të rreziqeve sipas nenit 41(6)(b)(ii) dhe (iii) të Ligjit dhe ecurisë së mëtejshme të procedurave, kjo periudhë kohe nuk e bën paraburgimin e z. Shala joproporcional. Për më tepër, në lidhje me përmendjen nga ana e Mbrojtjes të shkallës së kësaj çështjeje, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se pesha e akuzave nuk e mbështet konstatimin se vazhdimi i paraburgimit të z. Shala është joproporcional. Gjithashtu, çdo kohë shtesë e kërkuar nga Mbrojtja, në vetvete, nuk mjafton për ta konsideruar paraburgimin e z. Shala si joproporcional dhe, në çdo rast, për këtë aspekt tashmë është vendosur dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka caktuar një datë paraprake për kalimin e dosjes së çështjes

¹⁰⁷ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 14 prill 2022, konfidencial, f. 298-300.

¹⁰⁸ *Shih për shembull*, KSC-BC-2020-04, F00074, *Mbrojtësi i Specializuar, Mocion i Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit të Kërkesës së Saj sipas Rregullës 102(2) [sic]*, 9 shtator 2021, publik; F00076, *Prokurori i Specializuar, Përgjigje e Prokurorisë ndaj KSC-BC-2020-04/F00074 dhe Kërkesë për Ndryshimin e Afateve të Lidhura me Të*, 10 shtator 2021, publik; Transkripti, 23 shtator 2021, publik, f. 92, rreshtat 10-20; F00086, *Mbrojtësi i Specializuar, Kërkesë e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit të Kërkesës së Saj sipas Rregullës 102(2) [sic]*, 13 tetor 2021, publik; Transkripti, 14 prill 2022, konfidencial, f. 276-287.

Trupit Gjykues dhe afate të tjera për përfundimin e fazës paraprake.¹⁰⁹ Së fundi, në lidhje me argumentet e Mbrojtjes për të drejtën e z. Shala për jetë private dhe familjare, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se tashmë është konstatuar se: (i) pamundësia e vizitave të rregullta nga familja përbënte një masë proporcionale dhe të përkohshme, që ishte e nevojshme për shkak të shqetësimeve të lidhura me shëndetin publik, dhe këto kufizime tani janë hequr; (ii) shpeshtësia e vizitave familjare nuk mund t'i atribuohet DHS-së dhe z. Shala vazhdon ta ketë mundësinë që të komunikojë me anëtarët e familjes në mënyra të tjera; dhe (iii) mjeteve të kufizuara financiare në dispozicion të z. Shala duhet t'u jepet rëndësi shumë e vogël në kontekstin e kësaj çështjeje.¹¹⁰ Rrjedhimisht, argumentet e Mbrojtjes hidhen poshtë.

58. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se, në kuadër të rishikimit të rregullt të paraburgimit të z. Shala sipas nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, koha që z. Shala ka kaluar në paraburgim nuk është joproporcionale. Gjithashtu, duke pasur parasysh se nuk është arritur marrëveshje lidhur me fillimin e gjykimit, çdo diskutim lidhur me kohëzgjatjen në tërësi të paraburgimit të tij është i parakohshëm dhe hamendësues.¹¹¹

¹⁰⁹ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 14 prill 2022, konfidencial, f. 298-300.

¹¹⁰ Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 48; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 45; Vendimi i Katërt për Paraburgimin, para. 48; KSC-BC-2020-04, Transkripti, 14 janar 2022, publik, f. 181.

¹¹¹ *Shih gjithashtu* Apeli i Paraburgimit të *Krasniqit*, para. 43; KSC-BC-2020-06, IA010-F00008, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit*, 27 tetor 2021, konfidencial, para. 51 (Versioni i redaktuar publik u nxor po atë ditë, IA010-F00008/RED).

V. VENDIM

59. Për arsyet e lartpërmendura:

- (a) **VENDOS** të konfirmojë Vendimin e Tretë për Paraburgimin, lidhur me aspektet e kthyer nga Gjykata e Apelit për rishqyrtim;
- (b) **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Shala si rezultat i rishikimit të rregullt të paraburgimit të tij në pajtim me nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores;
- (c) **URDHËRON** Mbrojtjen që, nëse dëshiron, të paraqesë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Shala jo më vonë se **të mërkurën, 1 qershor 2022**, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores; dhe
- (d) **URDHËRON** ZPS-në që, nëse z. Shala vendos që të mos paraqesë parashtrime deri në afatin e lartpërmendur, të paraqesë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Shala jo më vonë se **të mërkurën, 8 qershor 2022** dhe z. Shala, nëse dëshiron, të paraqesë parashtrimet e tij jo më vonë se **të mërkurën, 15 qershor 2022**.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E premte, 22 prill 2022

Në Hagë, Holandë.